



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 139, Datë 21.05.2026

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË  
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “NRG POWER” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika 4 dhe 5, dhe nenit 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1249/4 prot., datë 19.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

**Konstatohet se:**

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “NRG Power” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

**1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit**

- Shoqëria, me shkresën nr. 1249 prot., datë 22.04.2026, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

**2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Kërkesa për Dokumentacion Plotësues**

- Shoqëria “NRG Power” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 13.07.2022, i ndryshuar, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199, datë 03.08.2022 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

**3. Përfundime dhe Kërkesa të tjera për Dhënien e Autorizimit**

- Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “NRG Power” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet 5 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të

*licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:*

#### **Plotësimi i kërkesave të nenit 5:**

- **Neni 5, pika 2** - Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë dhe/ose përfaqësuesit ligjor të autorizuar me prokurë.
- **Neni 5, pika 4** - Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.
- **Neni 5, pika 5** - Shoqëria kërkon që të mbahet konfidencial Vendimet e asamblesë të shoqërive SENS dhe DEPA dhe projekt-kontrata e shitjes së kuotave, e cila nga natyra duhet të mbrohet si konfidenciale.

Për sa kërkuar nga shoqëria, si dhe në kuptim të përcaktimeve të kësaj pike të rregullores, nga ana jonë është vlerësuar/klasifikuar dokumentacioni konform ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.03.2018, si vijon:

- Procesverbali/vendimi i mbledhjes së bordit të drejtorëve të shoqërisë SENS, datë 03.12.2025 dhe Procesverbali/vendimi i mbledhjes së bordit drejtues të shoqërisë DEPA, datë 04.12.2025 (*Këto dokumente do të konsiderohen si konfidenciale për arsye se përmbajnë të dhëna në lidhje me aktivitetin tregtar të shoqërisë dhe të dhëna financiare sensitive*)
- Marrëveshje për transferimin e kuotave dhe marrjen përsipër të detyrimeve, datë 04.12.2025 (*Ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv, për arsye se konsiderohet si dokument me natyrë juridike deklarative dhe lidhet me ndryshimin e ortakut të shoqërisë, informacion i cili reflektohet edhe në regjistrin tregtar (QKB).*)

#### **5. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 7:**

- **Pika 1** - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë kandidati i propozuar.
- **Pika 2** - Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrin tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:
  - **Gërma “a”** - Ekstrakti historik i regjistrin tregtar.
  - **Gërma “c”** - Vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar “Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. ”, datë 04.12.2025, nëpërmjet të cilit është miratuar transferimi i kuotës.
  - **Gërma “d”** - Marrëveshjet paraprake përkatëse:

- “Marrëveshje për transferimin e kuotave dhe marrjen përsipër të detyrimeve” datë 04.12.2025, nënshkruar midis palëve, me anë të së cilës është dakordësuar transferimi i kuotave nga ortaku aktual të shoqëria SENS, e cila më pas do të zotërojë 100% të kuotave.
- **Pika 3** - Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., nga ortakët e mëparshëm shoqëritë SENS dhe DEPA (secili me 50% të kuotave të kapitalit), tashmë sipas strukturës së kërkuar për 100% të kuotave të kapitalit të shoqëria SENS.
2. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto palë.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “NRG Power” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**